

L I G J
Nr. 8980, datë 12.12.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8560, DATË 22.12.1999,
"PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Fjalët "biznes i vogël" kudo ku ato përdoren në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999, zëvendësohen me fjalët "taksa vendore për biznesin e vogël".

Neni 2

Në nenin 33 pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Në rastet kur ligjet tatimore nuk kërkojnë pagimin e detyrimeve nëpërmjet deklarimit dhe në rastet kur administrata tatimore bazuar në fakte çmon se vlerësimi tatimor i bërë më parë nuk ka qenë i saktë, ajo mund të bëjë një vlerësim të ri, ku të argumentojë shkaqet e rivlerësimit me përllogaritjet përkatëse dhe ta dërgojë njoftim-vlerësimin tek tatim paguesi sipas pikës 1 të këtij neni. Në rastin e rivlerësimit në rritje të detyrimit tatimor, tatimpaguesit i lihet një afat sa dyfishi i afatit normal për pagimin e shtesës së detyrimit. Administrata tatimore, në kuptimin e kësaj pike të këtij neni, mund të bëjë një vlerësim ose të ndryshojë një vlerësim të bërë më parë derisa periudha kufizuese e përcaktuar në nenin 35 të këtij ligji nuk ka mbaruar.”.

Neni 3

Pas nenit 41 shtohet neni 42 me këtë përmbajtje:

"Neni 42

Radha e pagesës së detyrimeve tatimore

Pagesa e detyrimeve tatimore në Buxhetin e Shtetit bëhet sipas radhës së mëposhtme:

- a) detyrimi tatimor;
- b) interesat;
- c) dënimet administrative.”.

Neni 4

Neni 44 i ligjit ndryshohet si më poshtë:

“Neni 44

1. Nëse detyrimet tatimore nuk janë paguar në kohën e duhur, siç përcaktohet në ligjet e veçanta tatimore, tatimpaguesit janë të detyruar të paguajnë interesa mbi shumën e tatimit të papaguar

nga data në të cilën pagesa ka qenë e detyrueshme deri në datën në të cilën pagesa kryhet.

Interesi për mospagim në kohë të detyrimit tatimor është 2 për qind për muajin e parë të vonesës dhe 1,3 për qind për çdo muaj tjetër. Interesi minimal i zbatuar nuk mund të jetë më i vogël se 5 për qind. Përfshihen nga pagimi i interesave për pagesë të vonuar tatimpaguesit, që i nënshtrohen ligjit për taksën vendore për biznesin e vogël dhe tatimpaguesit, që i nënshtrohen tatimit mbi fitimin e thjeshtuar, sipas ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”.

2. Interesat zbatohen automatikisht dhe nuk hiqen nga asnjë autoritet.”.

Neni 5

Në nenin 46 të ligjit bëhen këto ndryshime:

Në shkronjën “a” të këtij neni shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Kryetari i degës së tatimeve ka të drejtë të nxjerrë një vendim të veçantë ekzekutiv për mbylljen e mjediseve, ku ushtron veprimtarinë e tij ekonomike tatimpaguesi, për aq kohë sa ky i fundit të ketë shlyer detyrimin e tij të papaguar. Këshilli i Ministrave përcakton rastet dhe procedurat, kur kryetari i degës së tatimeve merr një vendim të tillë.”.

Shkronja "c" e këtij neni ndryshohet si më poshtë:

“c) Nëse tatimpaguesi nuk mund të paguajë, organi tatimor kërkon fillimin e procedurave të falimentimit si kreditor i interesuar, në mbështetje të ligjit nr.8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”.”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3613, datë 20.12.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**